

**UDHËZIM**  
**Nr. 20, datë 22.9.2017**

**PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR. 52, DATË 3.12.2015, “PËR PËRCAKTIMIN E NIVELEVE TË GJUHËVE TË HUAJA DHE TË TESTEVE NDËRKOMBËTARE, PËR PRANIMET NË PROGRAMET E STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË DHE TË TRETË, NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 4, të nenit 76 dhe pikës 3, të nenit 78, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”,

**UDHËZOJ:**

1. Tabela nr. 1/1 e udhëzimit nr. 52, datë 3.12.2015, “Për përcaktimin e niveleve të gjuhëve të huaja dhe të testeve ndërkombëtare, për pranimet në programet e studimit të ciklit të dytë dhe të tretë, në institucionet e arsimit të lartë”, të ndryshuar, zëvendësohet me tabelën nr. 1/2, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.

2. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm, Drejtorja e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor, Drejtorja e Shërbimeve Juridike në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, si dhe institucionet e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**MINISTRI I ARSIMIT, SPORTIT  
DHE RINISË**  
**Lindita Nikolla**

Tabela 1/2

Në mbështetje të kuadrit të referencave për gjuhët, të krijuar nga Këshilli i Europës (2001), Kuadrit të Përbashkët European të Referencave për Gjuhët, si dhe në bashkëpunim me ambasadat e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Britanisë së Madhe, Gjermanisë, Francës, Italisë dhe Spanjës të akredituara në Republikën e Shqipërisë, Ministria e Arsimit dhe Sportit njih testet e gjuhëve të huaja dhe nivelet si më poshtë:

Niveli	B1	B2	C1
<i>Gjuha angleze</i>			
Cambridge	PET	FCE	CAE
IELTS	4.0 / 5.0	5.5 / 6.0	6.5 / 7.0
TOEFL Internet-based Test (iBT)	57/86	87/109	110/120
TOEFL Paper-based Test (ITP)	460	543	627
TOEIC	381 / 649	650 / 785	786 / 935
GESE	-	7, 8, 9	10, 11
APTIS	Aptis B1	Aptis B2	Aptis C
<i>Gjuha gjermane</i>			
Goethe-Institut, Goethe Zentrum	Goethe-Zertifikat B1	Goethe-Zertifikat B2	Goethe-Zertifikat C1
TestDaF	-	TDN 3 - TDN4	TDN 5
OSD	OSD-Zertifikat B1	OSD-Zertifikat B2	OSD-Zertifikat C1
<i>Gjuha franceze</i>			
TFI	345/604	605/824	825
DELFB	DELF B1	DELF B2	DALFC1
TCF	TCF 300 - 399	TCF 400 - 499	TCF 500 - 599
TEF	TEF 361-540	TEF 541-698	TEF 699-833
<i>Gjuha italiane</i>			
Peruggia	CELI2 livello2	CELI3 livello3	CELI4 livello4
Sienna	CILS uno B1	CILS 2	CILS 3
PLIDA	PLIDA certification B1	PLIDA certification B2	PLIDA certification C1
<i>Gjuha spanjolle</i>			
DELE	DELE inicial	DELE intermedio	DELE superior